



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETIT PËRFAQËSUES TË NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE, PËR REGJISTRIMIN E NISMËS LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE "PËR PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK"**

Në mbështetje të neneve 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 14, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidateve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve, i përbërë nga 8 (tetë) zgjedhës si vijon: zj. Anxhela Nasto, z. Arlind Qori, z. Jani Marka, zj. Mirela Ruko, zj. Geraldina Mançka, z. Redi Muçi, zj. Vitori Çipi dhe z. Xhuliano Bregasi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 3197 prot, datë 16.09.2022, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 198, datë 29.09.2022, vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik". Vendimi përcaktoi afatin 3 (tre) mujor nga hyrja në fuqi e tij, për mbledhjen e nënshkrimeve.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me nr. 3978 prot., datë 9.12.2022, me lëndë "Depozitimi i nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve, për propozimin e projektligjit "Për përcaktimin e minimumit jetik". Bashkëlidhur kërkesës është

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



"Për shqyrtimin e kërkesës së komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve, për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve "për përcaktimin e minimumit jetik"

depozituar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit midis Komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse dhe grupit të mbledhjes së nënshkrimeve, si edhe një shkresë shoqëruese e të gjitha nënshkrimeve të cilat janë identifikuar paraprakisht si të pavlefshme.

Referuar nenit 14, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, me depozitimin e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënëse të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korrigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

Në referim të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri ftoi përfaqësuesit e komitetit nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Në mbështetje të sa më sipër cituar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka bërë verifikimin e 5 (pesë) për qind të numrit të nënshkrimeve si dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, brenda afatit ligjor të parashikuar.

Në total janë depozituar 932 fletë, me 21 300 nënshkrime, të ndara në 6 dosje. Në referim të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë”, kërkohet që nisma ligjvënëse të nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës. Ka rezultuar se numri i zgjedhësve të cilët kanë mbështetur nismën e plotëson numrin prej 20 000 zgjedhësish të kërkuar nga ligji.

Përsa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nënshkrimet e depozituara nga përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të propozuar projektligjin “Për përcaktimin e minimumit jetik”, janë dorëzuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe si të tilla duhet të pranohen.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 2 dhe 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidateve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

## **V E N D O S:**

1. Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për përcaktimin e minimumit jetik”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**